

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË LLOGARISË SË WIZZ

1. PËRKUFIZIMET

Kushtet dhe shprehjet e përkufizuara në kushtet e përgjithshme të transportit të Wizz Air do të kenë të njëjtin kuptim kur përdoren në këto kushte të përgjithshme të llogarisë së WIZZ përveçse kur përcaktohet ndryshe më poshtë ose kur e kërkon ndryshe konteksti.

1.1. Kushtet e përgjithshme të transportit: kushtet e përgjithshme të transportit të Wizz Air (në varësi dhe në lidhje me subjektin e Wizz Air nga i cili lëshohet bileta e fluturimit) siç publikohen në faqen e internetit dhe siç ndryshohen herë pas here nga Wizz Air.

1.2. Pasagjeri: personi fizik që përdor shërbimet e transportit për pasagjerë të Wizz Air.

1.3. Ju ose klienti: personi fizik apo subjekti juridik që ka kryer regjistrimin.

1.4. Regjistrimi: regjistrimi i identifikimit tuaj dhe i të dhënave të kontaktit (emri, mbiemri, gjinia, prefiksi shtetëror, numri i celularit, adresa e emailit, shtetësia) në sistemin informatik të Wizz Air Hungary Ltd. Objekti i regjistrimit është hapja e një llogarie të WIZZ, duke mundësuar kontaktet me klientin dhe duke i mundësuar klientit të prenotojë fluturime, d.m.th. të blejë bileta fluturimi përmes faqes së internetit apo aplikacionit celular.

1.5. Faqja e internetit është www.wizzair.com

1.6. Aplikacioni celular është aplikacioni celular i WIZZ

1.7. Llogaria e WIZZ: një llogari ku ndiqen blerjet dhe bilanci aktual i krediteve WIZZ të klientit, e cila krijohet përmes regjistrimit. Llogaria e WIZZ vihet në punë dhe aksesit në të ofrohet nga Wizz Air Hungary Ltd. Llogaria e WIZZ mund të përdoret për të kryer rezervime dhe shërbime blerjeje për secilin nga subjektet e Wizz Air.

1.8. Numri i llogarisë së WIZZ: numri 10-shifror i identifikimit i llogarisë së WIZZ, i krijuar në përfundim të regjistrimit.

1.9. Krediti WIZZ: një instrument transaksioni i lidhur rreptësisht e vetëm me llogarinë e WIZZ. Klientët mund ta përdorin kreditin WIZZ për të blerë bileta fluturimi apo shërbime të tjera të secilit subjekt të Wizz Air. Krediti WIZZ mund të merret nga cilido subjekt i Wizz Air, sipas rastit, për promociione, zhvillim aktivitete, anulime fluturimesh të bëra nga Wizz Air apo aktivitete të tjera, okazione a evenimente, dhe përdoret në përputhje e në zbatim të kushteve të përgjithshme aktuale.

1.10. Monedha bazë: monedha e llogarisë së WIZZ, që përcaktohet nga transaksioni i parë i kryer në llogarinë e WIZZ.

1.11. Wizz Air ose ne: subjekti Wizz Air (gjegjësisht Wizz Air Hungary Ltd. ose Wizz Air UK Ltd., ose Wizz Air Abi Dhabi LLC, ose cilido subjekti tjetër i Wizz Air) që ju lëshon kreditet Wizz ose që operon fluturimin për të cilin keni blerë biletën e fluturimit dhe shërbime të tjera.

1.12. **Kushtet e përdorimit të kreditit WIZZ:** kushtet e përdorimit të kreditit WIZZ, që përbëjnë "Shtojcën 1" të kushteve aktuale të përgjithshme.

1.13. **Shërbimet e Wizz Air:** Transporti ajror i pasagjerëve dhe i bagazheve.

1.14. **Qendra telefonike:** Ekipet e shërbimit të klientit të Wizz Air përmes telefonit. Numrat e qendrës telefonike mund të gjenden në faqen tonë të kontaktit.

2. HAPJA E NJË LLOGARIE TË WIZZ

2.1. Një llogari e WIZZ mund të hapet nga klienti duke regjistruar të dhënat e veta personale, siç përshkruhet në pikën 1.3. dhe të dhënat e faturimit. Llogaria e WIZZ nevojitet për bërjen e rezervimeve në faqen e internetit ose në aplikacionin celular për fluturimet e operuara nga Wizz Air.

3. PËRDORIMI I BALANCËS NË LLOGARINË E WIZZ

3.1. Balanca e llogarisë së WIZZ përmban kreditet WIZZ të lëshuara e ngarkuara nga një a më shumë subjekte të Wizz Air, të cilat kredite WIZZ mund të kenë data të ndryshme skadimi dhe kriteret e ndryshme përdorimi. Kreditet WIZZ duhen përdorur sipas "Shtojcës 1" të kushteve aktuale të përgjithshme.

3.2. Bilanci i llogarisë së WIZZ mund të përdoret për blerjen e biletave dhe shumicës së shërbimeve të tjera të Wizz Air dhe për modifikimin e rezervimit aktual dhe/ose shtimin në rezervim të shërbimeve të mëtejshme të Wizz Air.

3.3. Në rezervimet e paguara nga llogaria e WIZZ, titullari i llogarisë së WIZZ duhet të jetë njëri prej pasagjerëve të përfshirë në rezervim dhe rezervimi nuk mund të përfshijë më shumë se 5 (pesë) persona.

3.4. Kur bëni apo ndryshoni një rezervim, adresa e emailit dhe fjalëkalimi që keni dhënë gjatë regjistrimit, i cili i përket llogarisë së WIZZ, duhet shkruar gjatë prenotimit përmes faqes së internetit apo aplikacionit celular.

3.5. Nëse shuma e kreditit WIZZ në llogarinë e WIZZ nuk është e mjaftueshme për të paguar për rezervimin, diferenca mund të paguhet me kartë bankare.

3.6. Nëse një rezervim bëhet në monedhë të ndryshme nga monedha bazë e llogarisë së WIZZ, shuma në monedhën e rezervimit do të konvertohet nga Wizz Air në shumë të monedhës bazë dhe kjo do të zbritet nga shuma e krediteve WIZZ që keni në llogarinë e WIZZ. Data e skadimit nuk mund ta kalojë periodën e kufizimit që parashtohet në ligjin e zbatueshëm.

3.7. Nëse Wizz Air anulon një fluturim që është paguar pjesërisht apo tërësisht nga llogaria e WIZZ me kredite të WIZZ, pasagjeri do të marrë mbrapsht së paku pjesën e paguar me kredite WIZZ në kredite WIZZ. Wizz Air ruan të drejtën të vendosë të rimbursojë më shumë se shuma e paguar nga pasagjeri për biletën e fluturimit dhe për shërbime të tjera të blera nga Wizz Air (nëse ka) në rastin e anulimeve të fluturimit sipas gjykimit të vet, i cili vendim mund të zbatohet mbi të gjithë shumën e biletës së fluturimit dhe shërbimet e blera nga pasagjeri nga Wizz Air, ose në pjesën e paguar nga kreditet WIZZ ose në pjesën e paguar me para.

3.8. Llogaria e WIZZ mund të përdoret për të blerë bileta fluturimi të operuar nga Wizz Air Hungary Ltd, Wizz Air UK Ltd, Wizz Air Abu Dhabi LLC dhe cilido subjekt tjetër i Wizz Air.

4. BILANCI I LLOGARISË SË WIZZ

4.1 Informacioni mbi bilancin e llogarisë së WIZZ mund të merret në internet në faqen internetit ose nga aplikacioni celular.

5. MBYLLJA E LLOGARISË SË WIZZ

5.1 Në rast se perceptohet dyshim i arsyeshëm për kundërvajtje apo krim, apo pikasen çfarëdo aktivitetesh të dyshimta dhe/ose jonormale, dhe/ose mashtruese në lidhje me llogarinë tuaj të WIZZ apo me përdorimin e krediteve të WIZZ, Wizz Air Hungary ruan të drejtën ta pezullojë llogarinë e WIZZ në formë të prerë për 30 ditë duke ju njoftuar me email apo çfarëdo forme tjetër për pezullimin dhe që të hetojë sa më lart, ose t'jua mbyllë llogarinë e WIZZ në formë të prerë. Në rast pezullimi dhe nëse Wizz Air Hungary e gjykon të nevojshme, pezullimi mund të zgjatet edhe për 30 ditë të tjera, me ç'rast do të njoftoheni në të njëjtën mënyrë si më lart në këtë dispozitë.

5.2. Përveç pezullimit të llogarisë së WIZZ, Wizz Air ruan të drejtën të ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme ligjore dhe të kontaktojë autoritetet përkatëse/policinë në rastet e përcaktuara në dispozitën 5.1.

5.3. Kreditet WIZZ që skadojnë gjatë pezullimit nuk do të shtyhen, kthehen apo rimbursohen. Wizz Air ruan të drejtën t'i anulojë kreditet WIZZ të përfutuara përmes apo në lidhje me kundërvajtjen, krimin apo aktivitetet e dyshimta dhe/ose jonormale, dhe/ose mashtruese të përmendura më sipër.

5.4. Kreditet WIZZ që ofrohen në llogarinë e WIZZ në çastin e mbylljes së llogarisë të WIZZ (mbyllja nga Wizz Air ose sipas vendimit të klientit) nuk konvertohen në para/para të thata, nuk kthehen apo nuk rimbursohen.

6. DISPOZITA TË TJERA

6.1. Klienti i përdor me konfidencialitet WIZZ ID, adresën e emailit që i përket llogarisë së WIZZ dhe fjalëkalimin e llogarisë së WIZZ. Wizz Air Hungary nuk mban përgjegjësi për dëmet që burojnë nga ndonjë lloj keqpërdorimi i WIZZ ID, adresës së emailit dhe fjalëkalimit, apo nga zbulimi i tyre ndaj personave të ndryshëm nga klienti (titullari i llogarisë së WIZZ).

6.2. Kjo marrëveshje lidhet mes Wizz Air Hungary Ltd. dhe klientit, ku Wizz Air Hungary garanton që kreditet WIZZ të lëshuara, dhëna e ngarkuara nga subjektet e tjera Wizz Air mund të hapen nga klienti në llogarinë e WIZZ dhe të përdoren për të blerë bileta dhe disa shërbime të tjera të Wizz Air. Kjo marrëveshje do të interpretohet dhe do të hyjë në fuqi në të gjitha aspektet e saj në përputhje me ligjet e Hungarisë. Mosmarrëveshjet që lindin nga kjo kontratë do të zgjidhen në radhë të parë përmes diskutimeve mes Palëve kontraktuese.

6.3. Përveçse siç specifikohet në këtë Marrëveshje, shërbimet e blera nga Wizz Air duke përdorur llogarinë e WIZZ do t'u nënshtrohen Kushteve të përgjithshme të transportit të Wizz Air.

6.4. Klienti deklaron se ai/ajo pranon kushtet e kësaj Marrëveshjeje. Klienti deklaron më tej se ai/ajo ka njoftuar përkatësisht Pasagjerin rreth kushteve të kësaj Marrëveshjeje dhe se Pasagjeri i kuptoi dhe i pranoi këto kushte.

6.5. Wizz Air ruan të drejtën e ndryshimit të këtyre kushteve. Wizz Air informon të gjithë klientët për ndryshime të tilla në faqen e internetit dhe/ose përmes aplikacionit celular. Me përdorimin e llogarisë së WIZZ ju miratoni e pranoi kushtet e përgjithshme aktuale.

1 korrik 2020

Shtojca 1.

Kushtet e përdorimit të kreditit WIZZ

1. INTERPRETIMI

1. Kushtet aktuale të përdorimit zbatohen për përdorimin e krediteve WIZZ të lëshuara e ofruara nga cilido subjekt i Wizz Air drejt klientit.

2. Kushtet aktuale të përdorimit interpretohen, përdoren dhe zbatohen së bashku me kushtet e përdorimit të llogarisë së WIZZ.

3. Kushtet aktuale të përdorimit përbëjnë një pjesë të pandashme të kushteve të përgjithshme të llogarisë së WIZZ, por në rast mospërputhjes mes dy dokumenteve mbizotërojnë kushtet aktuale të përdorimit.

4. Përkufizimet, termat dhe shprehjet e përcaktuara në kushtet e përgjithshme të llogarisë së WIZZ kanë të njëjtin kuptim kur përdoren në këto kushte përdorimit të kreditit WIZZ përveç nëse përcaktohet ndryshe më poshtë apo nëse konteksti i kërkon ndryshe.

2. E DREJTA E PJESËMARRJES

1. Ju mund të keni të drejtën e pjesëmarrjesh dhe mund të merrni kredite WIZZ për shkak të okazioneve, aktiviteteve dhe evenimenteve të përcaktuara nga Wizz Air. Krediti WIZZ mund të funksionojë si kompensim apo shpërblim në lidhje me aktivitetet që keni kryer në faqen e internetit, në aplikacionin celular apo në lidhje me çfarëdo aktiviteteve të ndërlidhura me Wizz Air apo të organizuara prej saj. Kreditet WIZZ mund të lëshohen për shkak të (duke përfshirë mes të tjerash) anulimit të fluturimeve, promocioneve, konkurseve, aktiviteteve në zhvillim nga subjektet e Wizz Air

2. Me përcaktimin e së drejtës suaj për pjesëmarrje, kreditet WIZZ duhet t'ju ngarkohen në llogarinë e WIZZ brenda periudhës së përcaktuar nga Wizz Air në komunikimin përkatës në lidhje me okazonin, aktivitetin apo evenimentin për të cilin i keni marrë kreditet WIZZ.

3. Kreditet WIZZ mund t'i merrni vetëm në rast se keni një llogari të WIZZ. Në rast okazionesh ku veproni si rezervuesi (sipas kushteve të përgjithshme të transportit) dhe i merrni kreditet WIZZ për llogari të pasagjerëve të tjerë, ju keni detyrimin të informoni pasagjerët për kreditet e marra Wizz, t'i përdorni kreditet WIZZ dhe të veproni në lidhje me kreditet WIZZ sipas dispozitave përkatëse të kushteve të përgjithshme të transportit.

3. PËRDORIMI, SHFRYTËZIMI, SKADIMI

3.1. Kreditet WIZZ të marra e ngarkuara në llogarinë e WIZZ mund t'i përdorni sipas kushteve aktuale të përdorimit.

3.2. Wizz Air gëzon të drejtën të përcaktojë kritere apo kufizime të mëtejshme mbi kreditet WIZZ dhe përdorimin e tyre në apo gjatë komunikimin në lidhje me okazonin, evenimentin apo aktivitetin për të cilin i merrni kreditet Wizz, në një komunikim të veçantë apo përndryshe, sipas gjykimit të vet, në këtë rast sipas kushteve aktuale të përdorimit dhe komunikimin përkatës i veçantë zbatohet në formë të përbashkët. Në rast mospërputhjes, zbatohen kushtet aktuale të përdorimit.

3.3. Kreditet WIZZ mund të përdoren për pagesa në rastin e blerjes së biletave të fluturimit apo shërbimeve të tjera të Wizz Air. Kreditet WIZZ mund të përdoren për pagesa apo rezervime,

duke përfshirë jo më shumë se 5 pasagjerë, ku titullari i llogarisë së WIZZ është njëri prej pasagjerëve të përfshirë në rezervim. Krediti Wizz mund të përdoret dhe për modifikimet e rezervimeve ekzistuese.

3.4. Wizz Air mund të përcaktojë përqindjen apo shumën e krediteve WIZZ ose raportin e krediteve WIZZ dhe të parave të lejuara për përdorim në transaksione të caktuara, sipas gjykimit të vet, ose mund të kufizojë përdorimin e krediteve WIZZ për blerje apo fluturime a shërbime të caktuara.

3.5. Monedha e krediteve WIZZ është e njëjtë me monedhën bazë të llogarisë suaj të WIZZ.

3.6. Data e skadimit, që shfrytëzimi i krediteve WIZZ të mund të ndryshojë në varësi të okazonit, evenimentit apo aktivitetit sipas të cilit ju janë ofruar, ju përcaktohet nga Wizz Air në komunikimin përkatës të lidhur me okazonin, evenimentin apo aktivitetin për shkak të të cilit keni marrë kreditet WIZZ

3.7. Kreditet WIZZ të ngarkuara në llogarinë tuaj të WIZZ mund t'i përdorni në pajtim me datën e tyre të skadimit, duke ndjekur vetëm rendin kronologjik të datave të skadimit. Wizz Air ruan të drejtën ta zgjasë vlefshmërinë e krediteve WIZZ në çfarëdo kohe, sipas gjykimit të vet.

3.8. Në rastin e blerjes së biletave të fluturimit apo të shërbimeve të tjera të Wizz Air, mund të përdorni kreditet WIZZ në llogarinë tuaj të WIZZ për të paguar pjesërisht ose mund ta paguani të gjithë shumën/çmimin me kredite WIZZ, në pajtim të dispozitës aktuale 3. dhe në varësi të kushteve konkrete të blerjes në fjalë.

3.9. Kreditet WIZZ në llogarinë e WIZZ janë të parimbursueshme dhe të patransferueshme. Nuk mund të kërkohet konvertim i krediteve WIZZ në para/para të thata, përveç nëse kjo përcaktohet apo lejohet posaçërisht nga Wizz Air.

4. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

4.1. Të gjitha promocionet, tarifat e fluturimit dhe ofertat e tjera speciale të ofruara nga Wizz Air u nënshtrohen kushteve të përgjithshme që i përkasin në mënyrë specifike asaj oferte.

4.2. Biletat e fluturimit dhe/ose shërbimet e blera duke përdorur kredite WIZZ nuk duhen ofruar për qëllime komerciale nga ju apo ndonjë palë e tretë ndryshe nga çfarë lejohet në kontratën që keni lidhur me Wizz Air. Kjo dispozitë zbatohet duke përfshirë, mes të tjerash, ankandet në internet apo platforma të tjera me bazë interneti.

4.3. Duhet të paraqisni të dhëna (personale) të sakta dhe të vërteta kur krijoni llogarinë e WIZZ dhe duhet t'i mbani këto të dhëna kur përdorni kreditet WIZZ. Nëse nuk arrini të pajtoheni me detyrimin e mësipërm, Wizz Air ruan të drejtën të veprojë sipas dispozitës 5 të kushteve të përgjithshme të llogarisë së WIZZ.

4.4. Wizz Air ruan të drejtën t'i ndryshojë njëanshëm këto kushte përdorimi në çdo kohë, duke ju njoftuar me email apo forma të tjera dhe duke botuar kushtet e ndryshuara të llogarisë së WIZZ në faqen e internetit dhe në aplikacionin celular.

4.5. Përveç nëse përcaktohet ndryshe këtu, në rezervimet e bëra apo në shërbimet e blera në faqen e internetit apo në aplikacionin celular duke përdorur kreditet WIZZ, zbatohen kushtet e përgjithshme të transportit të subjektit të Wizz Air që operon fluturimin.

5. LIGJI DREJTUES

5.1. Këto kushte përdorimi u nënshtrohen ligjit hungarez dhe juridiksionit joekskluziv të gjykatave hungareze.